

VENDIM
Nr. 8, datë 5.2.2020

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË
INFORMACIONIT QË MBAHET NË REGJISTRIN E KREDIVE TË
BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 127, pika 5, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 24, të rregullores nr. 67, datë 13.10.2010, “Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë” dhe të nenit 15, të udhëzimit nr. 68, datë 13.10.2010, “Për procedurën e nxjerrjes së raportit të kredimarrësit dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e përdorimit të informacionit që mbahet në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
 4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 69, datë 13.10.2010, i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, “Për miratimin e tarifave të përdorimit të informacionit që mbahet në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë”.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

**TARIFAT E PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT QË MBAHET NË
REGJISTRIN E KREDIVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

TARIFA E PËRDORIMIT	PËRSHKRIMI/DETAJIMI	TARIFA NË LEK
Tarifa për kërkim të suksesshëm nga bankat	E pagueshme çdo muaj	150
Tarifa për kërkim të suksesshëm nga subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet	E pagueshme çdo muaj	75
Tarifa për kërkesë nga individët	Pa pagesë	0
Tarifë për kërkesë nga subjektet tregtare	E pagueshme në momentin e pranimit të kërkesës	500